

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 7969  
E mërkurë, 15 janar 2025  
Çmimi 0.50



**NEVER AGAIN**  
kosovogenocide.com

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
www.awr-abbruch.de

## SOT SHËNOHET

# 15 JANARI, DITA E GJENOCIDIT SERB NË KOSOVË



Qendra "Gjenocidi në Kosovë-Plagë e hapur" dhe Parlamenti i Studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" organizojnë sot (e mërkurë), në orën 19:30, Ditën e Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit në Kosovë në sheshin "Skënderbeu"

në Prishtinë, përpara Teatrit Kombëtar të Kosovës. Në këtë orë do të ndizen qirinj në shenjë përkujtimi për viktimat e gjenocidit në Kosovë. Ata që nuk mund t'i bashkëngjiten këtij organizimi, të ndezin një qiri në ballkonet apo dritaret e shtëpive

të tyre. Më 16 maj 2019 Kuvendi i Kosovës miratoi rezolutën nëpërmjet së cilës krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë u cilësuan si gjenocid dhe u përcaktua që 15 janari të jetë Dita e Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit të Serbisë në Kosovë

## ASOCIACIONI, DIALOGU... KUSH ÇFARË DO TË BËJË?

F.3



## NGA DIALOGU KOSOVË - SERBI DERI TEK UKRAINA: ÇFARË PRITET NGA BE-ja KËTË VIT?

F.5

### OPINION

**KOSOVA PA RINI, ASNJË PARTI POLITIKE NUK KA FORUM RINOR FUNKSIONAL** F.6

Shkruan:  
Astrit GASHI



### AKTUALE



**WALKERI DOKUMENTON NË LIBËR MASAKRËN E REÇAKUT, KURTI: DËSHMI E KRIMEVE TË LUFTËS** F.2

### EKONOMI



**RRITEN ÇMIMET E KONSUMIT NË KOSOVË** F.8

**FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE: 247.2 MILIONË EURO KTHIMI BRUTO PËR 2024** F.8

### SPORT



**PËRKUSHTIM DHE OPTIMIZËM NGA FUTBOLLISTËT NË DITËN E TRETË TË KAMPIT STËRVITOR** F.10

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Nga dialogu Kosovë - Serbi deri tek Ukraina: Çfarë pritet nga BE-ja këtë vit?

PRISHTINË, 14 JANAR - Është e vështirë të anashkalohej inaugurimi i presidentit amerikan Donald Trump më 20 janar, kur parashikohet politika e Bashkimit Evropian për vitin 2025.

“Radio Evropa e Lirë” ka biseduar me disa zyrtarë në bllokun evropian në javët e fundit dhe të gjithë duket se po presin se si të reagojnë ndaj shumë sfidave të ndryshme që administrata e re amerikane mund të paraqesë për bllokun.

Kjo paparashikueshmëri, që pikë së pari duket se i bënë ata nervozë, së fundi u shpërfaq edhe me interesimin e Trumpit për Grenlandën, territorin danez. Por, ka edhe çështje të tjera për të cilat zyrtarët evropianë po përgatiten. Një nga to do të jenë tarifatat, duke besuar se premtimi zgjedhor i Trumpit për një tarifë universale prej 10 deri në 20 për qind ndaj importeve mund të ndodhë dhe kjo do të ishte e menaxhueshme, edhe pse ka frikë se disa produkte të caktuara do të goditen me tarifa më të larta.

Një tjetër çështje ka të bëjë me kërkesën për shpenzime më të mëdha të mbrojtjes, me presidentin e ardhshëm që kohën e fundit ka sugjeruar që 5 për qind e Bruto Prodhimit Vendor t'i kushtohet ushtrisë, teksa shumica e anëtarëve evropianë të NATO-s mezi arrijnë ta përmbushin objektivin e mëparshëm prej 2-përqindësh.

## Ukraina

E ardhmja e Ukrainës sigurisht se do të jetë në qendër të vëmendjes, veçmas nëse ndonjë marrëveshje për paqe apo për armëpushim mund të ndodhë gjatë vitit 2025. Sërish në Bruksel duket se është Trumpi dhe jo evropianët që do të duhet të kenë vëmendjen për këtë çështje. Në shumë mënyra, qëllimi për ta është që të paktën të sigurohet një “ulëse në tavolinë” – gjë që nuk është krejtësisht e sigurt. Fakti qëndron se evropianëve po u shterojnë idetë dhe nisimat kur bëhet fjalë për Kievin.

Këtu vlen të përmendet propozimi i fundit i bërë nga presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, i cili ka kërkuar që asetet e ngrira ruse në Perëndim, në vlerë prej miliarda dollarësh, t'i jepen Ukrainës për të blerë armë amerikane. Ky është shembulli i përkryer i shmangies së Evropës në disa mënyra. Në radhë të parë sepse paratë do të shkonin në buxhetin e ShBA-së në vend të shteteve evropiane dhe, së dyti, për shkak se shumica e parave ruse janë në BE. Kjo do të thotë se potencialisht do ta minonte Eurozonën si vend i mirë për investime nga shtetet e treta. BE-ja i ka përdorur këto asete të ngrira si garanci për kredinë e



fundit të G7-s për Ukrainën, që do t'i mbulojë shpenzimet e Kievit për të paktën për vitin 2025. Dhe, kjo është më e shumta që Evropa është e gatshme të bëjë deri në këto çaste.

## Sanksionet ndaj Rusisë

Ajo që është e sigurt është se BE-ja do të synojë t'i shkaktojë më shumë dhimbje Rusisë përmes sanksioneve. Gjatë Presidencës të Hungarisë të Këshillit të BE-së, në pjesën e dytë të vitit të kaluar, Brukseli miratoi masat më të dobëta, me qëllim që të mos përplasej me Budapestin, që është kritik i çdo mase kufizuese ndaj Moskës.

Tani, me Poloninë që e ka marrë udhëheqjen e Presidencës në Bruksel, ka shpresë për një paketë të re që do të jetë e gatshme në trevjetorin e nisjes së pushtimit të Ukrainës më 24 shkurt. Ka ide të ndryshme, sikurse shënjestrimi i gazit të lëngshëm natyror rus dhe këto ide do të shtyhen përpara nga disa shtete, por ka pak të ngjarë të ketë pajtim në mesin e 27 shteteve anëtare, i domosdoshëm që paketa të miratohet. Por, ka edhe aspekte të tjera në këtë çështje. Hungaria ende nuk ka hequr dorë nga kundërshtimi për sanksionet aktuale ekonomike të BE-së ndaj Rusisë. Afati për ta dhënë miratimin është deri më 31 janar dhe diplomatët, me të cilët ka biseduar REL-i, thanë se Budapesti ka kërkuar që fillimisht të bëhet inaugurimi i Trumpit para se blloku të marrë ndonjë vendim.

Ata thanë, po ashtu, se Hungaria ende nuk ka dhënë sinjale se ndonjë aspekt i sanksioneve duhet të zbutet ose nëse Budapesti dëshiron disa fonde të ngrira të BE-së t'i jepen, në mënyrë që të thotë po për sanksionet. Megjithatë, kjo

çështje mund të zgjidhet gjatë takimit të ministrave të Jashtëm më 27 janar në Bruksel, apo në ndonjë samit emergjent më vonë gjatë kësaj jave.

## Raportet Kosovë - Serbi

Dialogu për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, që ndërmjetësohet nga BE-ja që nga viti 2011, do të vazhdojë të jetë kyç për rajonin. Do të ketë përpjekje për ringjalljen e bisedimeve në nivelin më të lartë pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë.

Pas zgjedhjeve, pritet që shefja e re për politikë të jashtme e BE-së, Kaja Kallas, ta realizojë turneun e parë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Pyetja është nëse ajo do të mund të arrijë ndonjë rezultat, duke pasur parasysh se kryeministri aktual i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, deri më tani kanë shfaqur pak vullnet që bisedimet të kenë sukses.

Për t'i dalë në ndihmë, ajo me gjasë do ta zgjedhë danezin, diplomat karriere dhe ish-përfaqësues i posaçëm të BE-së për Bosnjë-Hercegovinën, Peter Sorensen, për të ndërmjetësuar në dialog. Ai pritet ta ketë rolin që ka ushtruar ish-ministri i Jashtëm slllovak Miroslav Lajčak në pesë vjetet e fundit, kur diplomacinë evropiane e udhëhoqte Josep Borrell.

Ndërkaq, në mesin e shteteve të Ballkanit Perëndimor aspiruese për në BE, Shqipëria do të vazhdojë drejt anëtarësimit, duke hapur kapituj të tjerë negocimi, pasi në gjysmën e dytë të vitit 2024 hapi shtatë.

Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovina me gjasë do të vazhdojnë të jenë të bllokuara në rrugën drejt BE-së për shkak të mungesës së reformave, ndërkaq

Mali i Zi, që veçse ka hapur të gjithë kapitujt, synon t'i afrohet edhe më shumë bllokut.

Deri më tani ky shtet ka arritur t'i përfundojë bisedimet për rreth një të pestën e tyre dhe ka vullnet në Bruksel që Mali i Zi të bëhet anëtar i 28 i bllokut deri në fund të dekadës - dëshmi se zgjerimi i BE-së ende është i mundur. Prandaj, komisionarja e re për Zgjerim, Marta Kos, me gjasë do ta ketë Podgoricën destinacion të parë gjatë vizitës në rajon që do të zhvillojë në fillim të këtij viti.

## Moldavia, Serbia, Ukraina më afër BE-së

Pjesë e zgjerimit janë edhe shtete të tjera. Për Ukrainën dhe Moldavinë pritet të ketë një vendim historik për hapjen e disa nga 33 kapitujt e zgjerimit gjatë Presidencës polake. Por, kjo nuk nënkupton se puna do të kryhet. Në mënyrë që të gjitha shtetet ta vazhdojnë integrimin, duhet pajtimi i të gjithëve, përfshirë edhe i vendeve skeptike si Hungaria dhe Sllovakia që janë gjithnjë e më shumë kritike ndaj integritit të Kievit në BE.

Ka gjasë që edhe Serbia të hapë kapituj të rinj, për herë të parë që nga nisja e pushtimit rus të Ukrainës. Shtetet kundërshtare, sikurse ato në Baltik, Polonia, madje edhe Holanda, duhet të pajtohen për këtë, edhe pse ato kanë shprehur zemërimin e tyre ndaj afërsisë së Beogradit me Rusinë dhe për kthimin prapa të sundimit të ligjit. Megjithatë, Gjeorgjia do të qëndrojë në vendnumëro. Në BE ende nuk ka një qëndrim se si të sillen me Tbilisin, teksa ekzekutivi atje ka ndërmarrë një sërë vendimesh kundërthënëse që janë kritikuar nga Perëndimi. Për sanksione ndaj personave të lidhur me partinë në pushtet Ëndrra Gjeorgjiane, sikurse vendosi

ShBA-ja, nuk ka konsensus, por ka të ngjarë që BE-ja ta suspendojë liberalizimin e vizave.

Në Bruksel mendojnë se Gjeorgjia tani do të jetë në pozitë të njëjtë si Turqia, zyrtarisht kandidatë për anëtarësim në BE, por de facto rruga e saj e anëtarësimit do të bllokohet.

## Situata në shtetet e tjera

Evropa, në aspektin politik, gjithnjë e më shumë po rrethohet nga forca populiste që po fitojnë terren gjithandej në kontinent.

Më 2025 disa shtete të mëdha të BE-së do të jenë dukshëm më të dobëta. Gjermania do ta nisë vitin me periudhë zgjedhore, pasi më 23 shkurt ajo do t'i mbajë zgjedhjet parlamentare.

Përderisa një koalicion mes qendrës së djathtë, CDU, dhe qendrës së majtë, SPD, ka të ngjarë të formohet pas zgjedhjeve, partia e ekstremit të djathtë, AfD, me gjasë do të fitojë 20 për qind të votave – që do të ishte rezultati më i mirë i arritur në nivel kombëtar.

Në Francë situata është më e paqëndrueshme për shkak të qeverisë jostabile që ka mbështetur dhe heshtur nga ekstremi i djathtë, derisa të mbahen zgjedhjet e reja në korrik.

Qeveritë në Spanjë dhe Holandë janë të lëkundura dhe mund të rrëzohen gjatë këtij viti. Më në lindje, miliardi çek, populist Andrej Babis, me gjasë do të fitojë zgjedhjet në tetor, duke e sjellë Pragën politikisht më afër Hungarisë dhe Sllovakisë.

Ndërkaq, në Austri, FPO-ja e ekstremit të djathtë së fundi mori për herë të parë mandatin për formimin e qeverisë, gjë që potencialisht mund ta rreshtojë edhe Vjenën në bllokun populist të Evropës Qendrore.

Sa i përket Polonisë, ekziston një mendim se lideri i saj, properëndimori Donald Tusk, tani është politikani më i fortë në BE. Ai, po ashtu, ndihmohet edhe nga udhëheqja e Presidencës së BE-së, ka marrëdhënie të mira me Uashingtonin dhe ka qenë shpenzuesja më e madhe ushtarake sa i përket përqindjes së Bruto Prodhimit Vendor në NATO. Por, edhe Varshava do të jetë e shpërqendruar nga zgjedhjet, pasi do t'i mbajë presidencialet më 18 maj dhe raundin e dytë më 1 qershor.

Aleati i Tuskut, kryetari i Varshavës, Rafal Trzaskowski, konsiderohet favoriti në këto zgjedhje dhe nëse ai fiton, Tusk do ta konsolidonte pushtetin në vend. Por, kandidati konservator Karol Nawrocki, pritet të jetë kundërkandidat i tij dhe fushata zgjedhore do ta marrë vëmendjen e vendit gjatë pranverës. /REL/



# Nga dialogu Kosovë - Serbi deri tek Ukraina: Çfarë pritet nga BE-ja këtë vit?

PRISHTINË, 14 JANAR - Është e vështirë të anashkalohet inaugurimi i presidentit amerikan Donald Trump më 20 janar, kur parashikohet politika e Bashkimit Evropian për vitin 2025.

"Radio Evropa e Lirë" ka biseduar me disa zyrtarë në bllokun evropian në javët e fundit dhe të gjithë duket se po presin se si të reagojnë ndaj shumë sfidave të ndryshme që administrata e re amerikane mund të paraqesë për bllokun.

Kjo paparashikueshmëri, që pikë së pari duket se i bënë ata nervozë, së fundi u shpërfaq edhe me interesimin e Trumpit për Grenlandën, territorin danez. Por, ka edhe çështje të tjera për të cilat zyrtarët evropianë po përgatiten. Një nga to do të jenë tarifatat, duke besuar se premtimi zgjedhor i Trumpit për një tarifë universale prej 10 deri në 20 për qind ndaj importeve mund të ndodhë dhe kjo do të ishte e menaxhueshme, edhe pse ka frikë se disa produkte të caktuara do të goditen me tarifa më të larta.

Një tjetër çështje ka të bëjë me kërkesën për shpenzime më të mëdha të mbrojtjes, me presidentin e ardhshëm që kohën e fundit ka sugjeruar që 5 për qind e Bruto Prodhimit Vendor t'i kushtohet ushtrisë, teksa shumica e anëtarëve evropianë të NATO-s mezi arrijnë ta përmbushin objektivin e mëparshëm prej 2-përqindësh.

## Ukraina

E ardhmja e Ukrainës sigurisht se do të jetë në qendër të vëmendjes, veçmas nëse ndonjë marrëveshje për paqe apo për armëpushim mund të ndodhë gjatë vitit 2025. Sërish në Bruksel duket se është Trumpi dhe jo evropianët që do të duhet të kenë vëmendjen për këtë çështje. Në shumë mënyra, qëllimi për ta është që të paktën të sigurohet një "ulëse në tavolinë" – gjë që nuk është krejtësisht e sigurt. Fakti qëndron se evropianëve po u shterojnë idetë dhe nismat kur bëhet fjalë për Kievin.

Këtu vlen të përmendet propozimi i fundit i bërë nga presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky, i cili ka kërkuar që asetet e ngrira ruse në Perëndim, në vlerë prej miliarda dollarësh, t'i jepen Ukrainës për të blerë armë amerikane. Ky është shembulli i përkryer i shmangies së Evropës në disa mënyra. Në radhë të parë sepse paratë do të shkonin në buxhetin e ShBA-së në vend të shteteve evropiane dhe, së dyti, për shkak se shumica e parave ruse janë në BE. Kjo do të thotë se potencialisht do ta minonte Eurozonën si vend i mirë për investime nga shtetet e treta. BE-ja i ka përdorur këto asetet e ngrira si garanci për kredinë e



fundit të G7-s për Ukrainën, që do t'i mbulojë shpenzimet e Kievit për të paktën për vitin 2025. Dhe, kjo është më e shumta që Evropa është e gatshme të bëjë deri në këto çaste.

## Sanksionet ndaj Ruisë

Ajo që është e sigurt është se BE-ja do të synojë t'i shkaktojë më shumë dhimbje Ruisë përmes sanksioneve. Gjatë Presidencës të Hungarisë të Këshillit të BE-së, në pjesën e dytë të vitit të kaluar, Brukseli miratoi masat më të dobëta, me qëllim që të mos përplasej me Budapestin, që është kritik i çdo mase kufizuese ndaj Moskës.

Tani, me Poloninë që e ka marrë udhëheqjen e Presidencës në Bruksel, ka shpresë për një paketë të re që do të jetë e gatshme në trevjetorin e nisjes së pushtimit të Ukrainës më 24 shkurt. Ka ide të ndryshme, sikurse shënjestrimi i gazit të lëngshëm natyror rus dhe këto ide do të shtyhen përpara nga disa shtete, por ka pak të ngjarë të ketë pajtim në mesin e 27 shteteve anëtare, i domosdoshëm që paketa të miratohet. Por, ka edhe aspekte të tjera në këtë çështje. Hungaria ende nuk ka hequr dorë nga kundërshtimi për sanksionet aktuale ekonomike të BE-së ndaj Ruisë. Afati për ta dhënë miratimin është deri më 31 janar dhe diplomatët, me të cilët ka biseduar REL-i, thanë se Budapesti ka kërkuar që fillimisht të bëhet inaugurimi i Trumpit para se blloku të marrë ndonjë vendim.

Ata thanë, po ashtu, se Hungaria ende nuk ka dhënë sinjale se ndonjë aspekt i sanksioneve duhet të zbutet ose nëse Budapesti dëshiron disa fonde të ngrira të BE-së t'i jepen, në mënyrë që të thotë po për sanksionet. Megjithatë, kjo

çështje mund të zgjidhet gjatë takimit të ministrave të Jashtëm më 27 janar në Bruksel, apo në ndonjë samit emergjent më vonë gjatë kësaj jave.

## Raportet Kosovë - Serbi

Dialogu për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, që ndërmjetësohet nga BE-ja që nga viti 2011, do të vazhdojë të jetë kyç për rajonin. Do të ketë përpjekje për ringjalljen e bisedimeve në nivelin më të lartë pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë.

Pas zgjedhjeve, pritet që shefja e re për politikë të jashtme e BE-së, Kaja Kallas, ta realizojë turneun e parë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Pyetja është nëse ajo do të mund të arrijë ndonjë rezultat, duke pasur parasysh se kryeministri aktual i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, deri më tani kanë shfaqur pak vullnet që bisedimet të kenë sukses.

Për t'i dalë në ndihmë, ajo me gjasë do ta zgjedhë danezin, diplomat karriere dhe ish-përfaqësues i posaçëm të BE-së për Bosnjë-Hercegovinën, Peter Sorensen, për të ndërmjetësuar në dialog. Ai pritet ta ketë rolin që ka ushtruar ish-ministri i Jashtëm slllovak Miroslav Lajčak në pesë vjetet e fundit, kur diplomacinë evropiane e udhëhoqte Josep Borrell.

Ndërkaq, në mesin e shteteve të Ballkanit Perëndimor aspiruese për në BE, Shqipëria do të vazhdojë drejt anëtarësimit, duke hapur kapituj të tjerë negocimi, pasi në gjysmën e dytë të vitit 2024 hapi shtatë.

Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovina me gjasë do të vazhdojnë të jenë të bllokuara në rrugën drejt BE-së për shkak të mungesës së reformave, ndërkaq

Mali i Zi, që veçse ka hapur të gjithë kapitujt, synon t'i afrohet edhe më shumë bllokut.

Deri më tani ky shtet ka arritur t'i përfundojë bisedimet për rreth një të pestën e tyre dhe ka vullnet në Bruksel që Mali i Zi të bëhet anëtar i 28 i bllokut deri në fund të dekadës - dëshmi se zgjerimi i BE-së ende është i mundur. Prandaj, komisionarja e re për Zgjerim, Marta Kos, me gjasë do ta ketë Podgoricën destinacion të parë gjatë vizitës në rajon që do të zhvillojë në fillim të këtij viti.

## Moldavia, Serbia, Ukraina më afër BE-së

Pjesë e zgjerimit janë edhe shtete të tjera. Për Ukrainën dhe Moldavinë pritet të ketë një vendim historik për hapjen e disa nga 33 kapitujt e zgjerimit gjatë Presidencës polake. Por, kjo nuk nënkupton se puna do të kryhet. Në mënyrë që të gjitha shtetet ta vazhdojnë integrimin, duhet pajtimi i të gjithëve, përfshirë edhe i vendeve skeptike si Hungaria dhe Sllovakia që janë gjithnjë e më shumë kritike ndaj integritetit të Kievit në BE.

Ka gjasë që edhe Serbia të hapë kapituj të rinj, për herë të parë që nga nisja e pushtimit rus të Ukrainës. Shtetet kundërshtarë, sikurse ato në Baltik, Polonia, madje edhe Holanda, duhet të pajtohen për këtë, edhe pse ato kanë shprehur zemërimin e tyre ndaj afërsisë së Beogradit me Rusinë dhe për kthimin prapa të sundimit të ligjit. Megjithatë, Gjeorgjia do të qëndrojë në vendnumëro. Në BE ende nuk ka një qëndrim se si të sillen me Tbilisin, teksa ekzekutivi atje ka ndërmarrë një sërë vendimesh kundërtënjësë që janë kritikuar nga Perëndimi. Për sanksione ndaj personave të lidhur me partinë në pushtet Ëndrra Gjeorgjiane, sikurse vendosi

ShBA-ja, nuk ka konsensus, por ka të ngjarë që BE-ja ta suspendojë liberalizimin e vizave.

Në Bruksel mendojnë se Gjeorgjia tani do të jetë në pozitë të njëjtë si Turqia, zyrtarisht kandidate për anëtarësim në BE, por de facto rruga e saj e anëtarësimit do të bllokohet.

## Situata në shtetet e tjera

Evropa, në aspektin politik, gjithnjë e më shumë po rrethohet nga forca populiste që po fitojnë terren gjithandej në kontinent.

Më 2025 disa shtete të mëdha të BE-së do të jenë dukshëm më të dobëta. Gjermania do ta nisë vitin me periudhë zgjedhore, pasi më 23 shkurt ajo do t'i mbajë zgjedhjet parlamentare.

Përderisa një koalicion mes qendrës së djathtë, CDU, dhe qendrës së majtë, SPD, ka të ngjarë të formohet pas zgjedhjeve, partia e ekstremit të djathtë, AfD, me gjasë do të fitojë 20 për qind të votave – që do të ishte rezultati më i mirë i arritur në nivel kombëtar.

Në Francë situata është më e paqëndrueshme për shkak të qeverisë jostabile që ka mbështetjen e heshtur nga ekstremi i djathtë, derisa të mbahen zgjedhjet e reja në korrik.

Qeveritë në Spanjë dhe Holandë janë të lëkundura dhe mund të rrezohen gjatë këtij viti. Në lindje, miliarderit çek, populist Andrej Babis, me gjasë do të fitojë zgjedhjet në tetor, duke e sjellë Pragën politikisht më afër Hungarisë dhe Sllovakisë.

Ndërkaq, në Austri, FPO-ja e ekstremit të djathtë së fundi mori për herë të parë mandatin për formimin e qeverisë, gjë që potencialisht mund ta rreshtojë edhe Vjenën në bllokun populist të Evropës Qendrore.

Sa i përket Polonisë, ekziston një mendim se lideri i saj, propeëndimori Donald Tusk, tani është politikani më i fortë në BE. Ai, po ashtu, ndihmohet edhe nga udhëheqja e Presidencës së BE-së, ka marrëdhënie të mira me Uashingtonin dhe ka qenë shpenzuesja më e madhe ushtarake sa i përket përqindjes së Bruto Prodhimit Vendor në NATO. Por, edhe Varshava do të jetë e shpërqëndruar nga zgjedhjet, pasi do t'i mbajë presidencialet më 18 maj dhe raundin e dytë më 1 qershor.

Aleati i Tuskut, kryetari i Varshavës, Rafal Trzaskowski, konsiderohet favoriti në këto zgjedhje dhe nëse ai fiton, Tusk do ta konsolidonte pushtetin në vend. Por, kandidati konservator Karol Nawrocki, pritet të jetë kundërkandidati i tij dhe fushata zgjedhore do ta marrë vëmendjen e vendit gjatë pranverës. /REL/



NE NUK HARROJMË! NDIZE NJË QIRI PËR VIKTIMAT E GJENOCIDIT NË KOSOVË

# SOT SHËNOHET 15 JANARI, DITA E GJENOCIDIT SERB NË KOSOVË

Qendra "Gjenocidi në Kosovë-Plagë e hapur" dhe Parlamenti i Studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" organizojnë sot (e mërkurë), në orën 19:30, Ditën e Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit në Kosovë në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë, përpara Teatrit Kombëtar të Kosovës. Në këtë orë do të ndizen qirinj në shenjë përkujtimi për viktimat e gjenocidit në Kosovë. Ata që nuk mund t'i bashkëngjiten këtij organizimi, të ndezin një qiri në ballkonet apo dritaret e shtëpive të tyre. Më 16 maj 2019 Kuvendi i Kosovës miratoi rezolutën nëpërmjet së cilës krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë u cilësuan si gjenocid dhe u përcaktua që 15 janari të jetë Dita e Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit të Serbisë në Kosovë

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 14 JANAR - Qendra "Gjenocidi në Kosovë-Plagë e hapur" dhe Parlamenti i Studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" organizojnë manifestimin qendror në Sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë përpara Teatrit Kombëtar të Kosovës, ku më 15 janar 2025,

në orën 19:30, do të ndizen qirinj në shenjë përkujtimi për viktimat e gjenocidit në Kosovë. Ata që nuk mund të na bashkëngjiten, të ndezin një qiri në ballkonet apo dritaret e shtëpive të tyre. Më 16 maj 2019 Kuvendi i Kosovës miratoi rezolutën nëpërmjet së cilës krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë u cilësuan si gjenocid dhe u përcaktua që 15 janari të jetë

Dita e Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit të Serbisë në Kosovë.

Me qëllim që kjo ditë të shënohet në mënyrë dinjitoze, Qendra "Gjenocidi në Kosovë-Plagë e hapur" ka ftuar të gjithë shqiptarët, në cilindo shtet qofshin, që në mbrëmjen e kësaj date, në orën 19:30, të ndezin një qiri, në shenjë nderimi të mbi 10 mijë civilëve shqiptarë të vrarë gjatë luftës 1998-1999, të mbi 20 mijë vajzave/grave shqiptare ndaj të cilave është ushtruar dhunë seksuale dhe të rreth 1 milion shqiptarëve të dëbuar me dhunë nga vatrat e tyre.

Si rezultat i një bashkërenditjeje të aktivitetit të institucioneve dhe shoqatave të ndryshme shqiptare, kjo ditë do të

shënohet në Kosovë, Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Suedi, Norvegji, Danimarkë, Gjermani, Francë, Zvicër, Itali, Greqi, në ShBA dhe në vende të tjera.

Serbia kreu gjenocidin në Kosovë dhe ende nuk është dënuar për krimin më të rëndë që njeh njerëzimi. Fatkeqësisht, përveç Kuvendit të Kosovës që ka përkufizuar në mënyrë të qartë natyrën e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, deri në ditën e sotme asnjë vend tjetër nuk e ka emërtuar qartë dhe pa ambiguitet faktin se shteti serb ka kryer gjenocid kundër shqiptarëve. Dihet se faktet nuk flasin vetë, prandaj është në përgjegjësinë e intelektualëve të fushave të ndryshme që t'i bëjmë "të

flasin" për të nxjerrë në shesh të vërtetën e plotë për atë që përjetoj populli shqiptar i Kosovës.

Në funksion të këtij qëllimi, më 30 qershor 2019 në Bernë të Zvicrës u themelua Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur". Kjo qendër ka për qëllim të shndërrohet në rrjet të organizuar intelektualësh dhe veprimtarësh, të cilët angazhohen vullnetarisht për informimin e drejtë dhe ndriçimin e plotë të gjenocidit në Kosovë dhe të këmbëngul në domosdoshmërinë e ngadhënjimit të drejtësisë.

Misioni i kësaj qendre është përhapja e së vërtetës për gjenocidin në Kosovë dhe sensibilizimi i opinionit deri në arrijten e drejtësisë.

Aktiviteti i Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur" është krejtësisht paqësor. "Ne synojmë që, përmes botimit të librave, broshurave, artikujve e fotografive; përmes organizimit të ekspozitave dhe manifestimeve të ndryshme, ta japim kontributin tonë në përhapjen e së vërtetës dhe kërkimin e drejtësisë për viktimat e gjenocidit në Kosovë", theksohet në faqen zyrtare të kësaj qendre. Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur" udhëhiqet nga politologu Bardhyl Mahmuti, ndërsa Adnan Asllani është zëvendës.




## Është përkthyer në greqisht romani "Eskadronët e vdekjes"

Prishtinë, 14 janar - Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur" ka njoftuar se është përkthyer në greqisht romani "Eskadronët e vdekjes". "Për Ditën e Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit që ka kryer Serbia ndaj shqiptarëve në Kosovë, 15 janarin e këtij viti e shënojmë edhe me realizimin e përkthimit në greqisht të romanit 'Eskadronët e vdekjes'

të autorit Bardhyl Mahmuti. Rikujtojmë se më 15 janar të vitit 2024, Lidhja e Shkrimtarëve e Kosovës shpalli këtë roman si libër më të mirë kushtuar gjenocidit në Kosovë. Falë mbështetjes suaj financiare, Qendra 'Gjenocidi në Kosovë-Plagë e hapur' realizoi këtë projekt - përkthimin në greqisht të romanit 'Eskadronët e vdekjes'. Një falënderim i

veçantë për Armela Hysin, Brikena Qamën dhe Tzois Keliraqin, të cilët përkthyen dhe redaktuan romanin dhe janë të angazhuar për të gjetur një shtëpi botuese në Greqi, që lexuesi në gjuhën greke të ketë mundësi të njihet me krimin më të shëmтуar në fundshekullit XX", ka njoftuar Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e hapur".











## Asociacioni, dialogu... kush çfarë do të bëjë?

Prishtinë, 14 janar - Ndërsa Kosova u afrohet zgjedhjeve të saj parlamentare më 9 shkurt, vendi përballlet me disa sfida kritike që mund ta formësojnë të ardhmen e tij. Nga themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe e deri te normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë, agjenda duket e ngjeshur. Me pyetjen se si do t'i adresojnë ato, "Radio Evropa e Lirë" iu drejtua të katër kandidatëve për kryeministër - Albin Kurtit të Vetëvendosjes, aktualisht në pushtet; Bedri Hamzës të Partisë Demokratike të Kosovës; Lumir Abdixhikut të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Ramush Haradinajt të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, por prej asnjërit nuk mori përgjigje. Në vend të tyre u përgjigjën zyrtarët e partive, e në rastin e Vetëvendosjes as ata.

### Si do të adresohet çështja e Asociacionit?

Për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje qysh në vitin 2013, por Kosova nuk e zbatoi atë, nga frika se mund të ndikonte në funksionalitetin e shtetit.

Në vitin 2023 kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, arritën edhe atë që njihet si Marrëveshja Bazë, e cila, përveç një niveli të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë, kërkon nga palët ta respektojnë integritetin dhe sovranitetin territorial të njëra-tjetres si dhe t'i njohin dokumentet dhe simbolet kombëtare të njëra-tjetres. Serbia, në disa raste, është shprehur kundër saj dhe, sipas Kurtit, Vuçiqi ka refuzuar ta nënshkruajë atë. Duke folur së voni në një intervistë për median "Kosovapress", Kurti tha se Asociacioni nuk duhet të vendoset në qendër të raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sipas tij, Marrëveshja Bazë, e cila e adreson edhe çështjen e Asociacionit, duhet të zbatohet tërësisht. "Unë besoj që duhet të përqendrohemi te Marrëveshja Bazë. Neni 7 flet për vetëmenaxhimin e komunitetit serb. Le të adresohet aty", tha Kurti. Duke folur për "Radion Evropa e Lirë", Mimoza Ahmetaj, nënkryetare e Partisë Demokratike të Kosovës, thotë se formimi i Asociacionit është obligim i Kosovës edhe për shkak se

është pranuar nga ana e Kurtit me anë të Marrëveshjes Bazë. "Për ne është me rëndësi të respektohet Kushtetuta", thotë Ahmetaj, por nuk specifikon se cili është plani i PDK-së për Asociacionin në të ardhmen. Bashkësia ndërkombëtare ka hartuar një draft-statut për këtë asociacion dhe ka kërkuar nga Kosova ta dërgojë për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese, të cilin veprim Kosova nuk e ka bërë. Për nënkryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lutfi Haziri, ky draft-statut është rezultat i Marrëveshjes Bazë, të cilën ai e konsideron të keqe. Ai thotë se në rast se LDK-ja i fiton zgjedhjet e 9 shkurtit dhe merr pushtetin në krye me liderin e saj, Lumir Abdixhiku, do të bëjë përpjekje për rishikimin e draft-statutit të Asociacionit, në mënyrë që ai të mos jetë në kundërshtim me organizimin kushtetues të Kosovës. "Dokumenti, si i tillë, para se të kalojë në shkallën tjetër [për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese] duhet - me ndërmjetësit ndërkombëtarë, në veçanti me rol të forcuar të amerikanëve në këtë proces - të shihet, që të jetë në përputhje me obligimet, zotimet kushtetuese që i ka Republika e Kosovës", thotë

Haziri. Lulzim Blaka, zyrtar për informim në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, thotë se kandidati për kryeministër i kësaj partie, Ramush Haradinaj, planifikon që draft-statutin për Asociacionin ta dërgojë për vlerësim në Gjykatën Kushtetuese. "Pas përgjigjes së Kushtetueses, duhet të procedohet sipas obligimeve që i ka marrë Kosova si shtet", thotë Blaka, duke shtuar se kjo nënkupton edhe zbatimin e Marrëveshjes për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe.

### Si do të adresohet dialogu me Serbinë?

Nga viti 2011 Kosova dhe Serbia janë në negociata për normalizimin e marrëdhënieve. Shumë prej marrëveshjeve të arritura mbeten pa u zbatuar dhe palët akuzojnë njëra-tjetren për angazhim jo të duhur. Kurti dhe Vuçiqi janë takuar për herë të fundit në shtator të vitit 2023. Pak ditë pas atij takimi ka ndodhur sulmi i armatosur në Banjskë të Zveçanit, për të cilin Kosova ka fajësuar Serbinë. Për vazhdimin e dialogut, Kurti në disa raste ka kërkuar nga Serbia ta dorëzojë Millan

Radoiçiqin, i cili e ka pranuar përgjegjësinë për organizimin e sulmit, si dhe nga Vuçiqi ta nënshkruajë Marrëveshjen Bazë. Ahmetaj nga PDK-ja thotë se kjo parti planifikon t'i qaset dialogut me synimin "për arritjen e marrëveshjes përfundimtare", "...në mënyrë që Kosova të vazhdojë më tutje në procesin e konsolidimit të shtetit", sipas saj. Në një paraqitje në TV21 të Kosovës, kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, ka thënë se në dialogun e mëtejshëm me Serbinë duhet të rishikohet Marrëveshja Bazë, e cila është "oferta më e varfër" që ka marrë Kosova. "Kjo nënkupton që disa pjesë duhet të rishikohen dhe të ndryshohen", ka thënë Hamza. Haziri thotë se për LDK-në dhe kandidatin e saj për kryeministër, Lumir Abdixhiku, njohja "de jure" e Kosovës nga Serbia do të jetë qëllimi kryesor i dialogut me këtë vend në të ardhmen. "Do të krijojmë ambient që Kosova në tavolinë, në raport të drejtpërdrejtë me Bashkimin Evropian, me rol të forcuar të ShBA-së si lehtësuese, si dhe në koordinim jashtëzakonisht të mirë edhe me NATO-n si



# Komisionarja për Zgjerim: Presim lëvizje në Kosovë pas zgjedhjeve

PRISHTINË, 14 JANAR - Komisionarja e Bashkimit Evropian për Zgjerim, Marta Kos, e të martën e përmendi shkurtimisht Kosovën para deputetëve në Komisionin për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian në Bruksel. Ajo tha se zgjerimi i BE-së sot është ndryshe nga mënyra se si ishte para katër a pesë vjetësh dhe se tash "kemi një moment të ri pozitiv në BE". "Për herë të parë në dhjetë vjetët e fundit kemi mundësinë që gjatë mandatit tonë të anëtarësojmë në BE një, dy apo tri vende të reja. Por, u kam thënë partnerëve javën e fundit, se nuk do të ketë lëshime kur bëhet fjalë për kriteret themelore dhe vlerat e BE-së", tha ajo.

Për Kosovën ajo foli krejt në fund kur u pyet nga një deputet i Parlamentit Evropian se çfarë pret nga zgjedhjet në Kosovë. "Kosova... Nuk e përmenda Kosovën. Atje do të ketë zgjedhje. Nuk pres se do të mund të lëvizim para zgjedhjeve, por shpejt pas zgjedhjeve duhet të lëvizim. Sepse nuk mund të flasim për rajonin e Ballkanit Perëndimor nëse nuk flasim për dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës ose ndaras se çfarë është duke bërë Kosova e çfarë është duke bërë Serbia", tha



Kos. Komisionarja shtoi se këtë vit pret zhvillime pozitive në procesin e zgjerimit dhe se pret përparim më të madh sesa që ka pasur në dhjetë vjetët e fundit. "Mund të kemi përparim gjatë Presidencës

polake më shumë sesa që kishim në dhjetë vjetët e fundit. Mund të kemi deri në dhjetë konferenca ndërqeveritare", theksoi ajo.

Kos, gjithashtu, paralajmëroi se së shpejti do t'i vizitojë Malin e Zi dhe Shqipërinë, vende të cilat

ajo i sheh si më të avancuarat në procesin e zgjerimit. "Mali i Zi ka vizion t'i përmbyllë negociatat deri më 2026 dhe Shqipëria deri në vitin 2027. Ne do t'i mbështesim ato, por duhet një punë shumë e madhe. Parimi i procesit të

bazuar në merita duhet të jetë i vlefshëm edhe për vendet candidate, por edhe për vendet anëtare të BE-së. Pra, kur kandidatët t'i përmbushin kriteret, atëherë vendet e BE-së duhet ta mundësojnë ecjen përpara", ka deklaruar Kos.

Pas zgjedhjeve që mbahen më 9 shkurt në Kosovë, pritet që shefja e re për politikë të jashtme e BE-së, Kaja Kallas, ta realizojë turneun e parë të saj në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Në anën tjetër, i dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Mirosllav Lajçak, ka paralajmëruar se fokusi i kësaj jave në Bruksel do të jetë te takimi i parë i Komisionit të Përbashkët për Personat e Zhdukur në luftën e fundit në Kosovë.

Komisioni i Përbashkët është pjesë e Deklaratës së Përbashkët për Personat e Zhdukur, të cilën Kosova dhe Serbia e kanë arritur në vitin 2023, në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Në takimin e fundit në Bruksel, më 17 dhjetor të vitit të kaluar, kryenegociatori i Kosovës, Besnik Bislimi, dhe ai i Serbisë, Petar Petković, kanë thënë se janë pajtuar për zbatimin e plotë të Deklaratës për Personat e Zhdukur.

## Dibrani, pjesëmarrës në konferencën më të rëndësishme të sistemit korrektues në Amerikë

Prishtinë, 14 janar - Me ftesë të Departamentit të Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Ismail Dibrani, së bashku me oficerë korrektues të inteligjencës, po marrin pjesë në Konferencën Vjetore të Shoqatës Korrektuese Amerikane (ACA) e cila po zhvillohet në Orlando, Florida. Kjo konferencë, një nga më të rëndësishmet në fushën e sistemit korrektues, ofron një platformë të shkëlqyer për shkëmbimin e përvojave dhe ideve midis drejtuesve të shërbimeve korrektuese nga

Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera. Gjatë pjesëmarrjes së tij, drejtori Dibrani ka zhvilluar takime të rëndësishme, duke përfshirë edhe takimin me presidentin e ri të Shoqatës Ndërkombëtare të Shërbimeve Korrektuese (ACA), Ricky D. Dixon. Ai ka bashkëbiseduar me udhëheqës të tjerë të shërbimeve korrektuese nga ShBA-ja dhe vendet e tjera, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë sektor. Ky është një rast i veçantë për të shkëmbyer përvoja dhe për të diskutuar praktikatat më të mira në këtë

fushë. Gjithashtu, konferenca përfshin panele, ligjërata dhe seanca të shumta që trajtojnë tema të rëndësishme. Disa prej tyre përfshijnë sigurinë në burje, programet rehabilituese, teknologjinë informative, shëndetin mendor, menaxhimin e institucioneve korrektuese dhe njësitë ekonomike, si dhe shumë çështje të tjera relevante. Ambasada e ShBA-së mbetet partnerja jonë kryesore në përpjekjet për forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.



partner i madh, t'i mbyllë çështjet që kanë të bëjnë me procesin e dialogut", thotë Haziri.

Blaka i AAK-së thotë se dialogu për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi ka degraduar.

Nëse Haradinaj merr pushtetin, sipas tij, ai do të synojë që këtë proces ta përmbyllë me njohje të ndërsjellë. "Dialogu duhet të rikthehet siç ka qenë, të dialogojmë për marrëveshjen gjithëpërfshirëse dhe obliguese për të dyja palët, me njohje reciproke. Kjo ka qenë ajo që zoti Haradinaj e ka potencuar gjithmonë dhe

kështu mendojmë të vazhdojmë edhe pas zgjedhjeve të 9 shkurtit", thotë Blaka.

### Si do të adresohen marrëdhëniet me aleatët perëndimorë?

Gjatë vitit të kaluar Kosova ishte disa herë në shënjestër të kritikave nga aleatët ndërkombëtarë për shkak të disa veprimeve në veriun e vendit të banuar me shumicë serbe.

Aleatët ndërkombëtarë kërkojnë që Kosova ta trajtojë në dialog çdo çështje që lidhet

me këtë zonë, por kjo nuk ka ndodhur. Ndaj zyrtarët amerikanë në disa raste kanë thënë se veprimet e Qeverisë së Kosovës i kanë lëkundur marrëdhëniet me ShBA-në. Në përgjigje, Kurti ka theksuar se ShBA-ja është partnerja kryesore e Kosovës por kjo, sipas tij, nuk do të thotë se ato duhet të pajtohen gjithmonë. Kurti, po ashtu, ka theksuar se do të bashkëpunojë ngushtë me presidentin e zgjedhur të ShBA-së, Donald Trump. Për shkak të tensioneve në veri, Kosova, prej kohësh, është edhe subjekt i disa masave ndëshkuese të Bashkimit Evropian.

Ahmetaj e PDK-së thotë se nëse kjo parti i fiton zgjedhjet, ajo do të vazhdojë ta bashkërendojë agjendën e Kosovës me partnerët ndërkombëtarë. "Do të vazhdojmë që në koordinim me miqtë tanë, t'i heqim këto masa [të BE-së]", thotë Ahmetaj.

"Ne do t'i ndryshojmë raportet e kushtëzuara që qeveria e Kurtit ia ka sjellë Kosovës", thotë në anën tjetër Haziri i LDK-së. Edhe për AAK-në rikthimi i miqësisë dhe mirëbesimit me partnerët ndërkombëtarë do të jetë detyrë kryesore, thotë Blaka nga kjo parti. Në shenjë

mirëbesimi, thotë ai, Kosova do t'i përmbushë të gjitha obligimet që ka marrë përballë partnerëve ndërkombëtarë.

Kandidatët që do të marrin pjesë në zgjedhjet e 9 shkurtit nisën zyrtarisht fushatën zgjedhore më 11 janar, por premtime e zotime ka kohë që bëjnë.

Në një anketë që publikoi "Radio Evropa e Lirë" në uebfaqen e saj më 13 janar, politika e jashtme nuk duket se është vendimtare për pjesëmarrësit në këtë sondazh - para saj renditen politika ekonomike, reforma në shëndetësi dhe arsimit.



# Kosova pa rini, asnjë parti politike nuk ka forum rinor funksional



Shkruan: Astrit GASHI

Në prag të zgjedhjeve të 9 shkurtit partitë politike në Kosovë kanë hyrë në garë pa funksionalizuar forumet e tyre rinore. Kjo u dëshmuar qartë në hapjen e fushatave të të gjitha partive, ku mungesa e zërit dhe përfaqësimit të rinjve ishte evidente. Zëri i tyre nuk u dëgjua askund. Edhe pse disa drejtues të rinisë figurojnë në listat për deputetë, forumet rinore janë praktikisht joaktive dhe mungojnë në çdo aspekt të veprimitarisë politike të

partive. Ligji detyron disa lista zgjedhore, por kjo përfshirje shpesh është formale dhe jo për shkak të meritës. Të jemi të sinqertë, shumë nga kandidatët e rinisë nuk i meritojnë vendet pa treguar përkushtim dhe punë në aktivitete rinore.

Ky realitet tregon qartë se të rinjtë e Kosovës nuk shohin të ardhme në vendin e tyre. Kjo lidhet ngushtë me migrimin masiv, i cili ka ulur popullsinë e Kosovës në vetëm 1.6 milionë banorë. Mungesa e përfshirjes së rinisë në jetën politike është një sinjal alarmi për shoqërinë dhe një tregues i qartë i shkëputjes së tyre nga proceset vendimmarrëse. Nëse ky trend vazhdon, Kosova do të përballet me sfida të mëdha që rrezikojnë zhvillimin dhe stabilitetin e saj.

Një shtet pa rini nuk ka të

ardhme, dhe një parti pa forum rinor është e destinuar të shuhet. Në botë, forumet rinore përbëjnë zemrën e partive politike, duke krijuar hapësira për të rinjtë që të mësojnë, të zhvillohen dhe të bëhen liderë të ardhshëm. Në Evropë, forumet rinore janë motorë të rëndësishëm të partive, duke përfaqësuar interesat e të rinjve, duke nxitur aktivizmin dhe duke ndikuar drejtpërdrejt në proceset vendimmarrëse.

Në Kosovë, partitë politike nuk kanë vetëm një krizë të angazhimit të rinisë, por edhe mungesë të investimit në të. Për të krijuar një brez të ri aktiv politikisht dhe socialist, është e domosdoshme që partitë të ndajnë buxhete specifike për zhvillimin e forumeve rinore. Ky financim mund të përdoret për organizimin e trajnimeve,

debateve dhe aktiviteteve që i edukojnë dhe angazhojnë të rinjtë në çështjet politike dhe sociale.

Në vend që të mbështesin të rinjtë, shumë parti rezervojnë vende të privileguara për fëmijët e politikanëve, duke e kthyer Kosovën nga një republikë demokratike në një monarki nepotiste. Kjo situatë ka bërë që rinia, pjesa më vitale e shoqërisë, të largohet jo vetëm nga vendi, por edhe nga politika. Nëse ky trend vazhdon, Kosova rrezikon të mbetet pa brezin e ri që do të udhëheqë ndryshimin dhe zhvillimin e saj.

Shembujt nga Evropa tregojnë se forumet rinore jo vetëm që ndihmojnë në edukimin e liderëve të ardhshëm, por gjithashtu i ofrojnë partive një burim të vazhdueshëm energjie dhe ide të reja. Arbër Gashi nga Suedia, një i ri nga

Rinia Socialdemokrate, sot është pjesë e Parlamentit Suedez. Ai është dëshmi se investimi në rini dhe forumet rinore mund të sjellë ndryshime të mëdha në politikë.

Kosova mund dhe duhet të ndjekë këto modele. Një nga hapat e parë që duhet ndërmarrë është ndarja e buxheteve të veçanta për aktivitetet e forumeve rinore, duke u siguruar që këto forumet të jenë funksionale dhe të zëshme. Përfshirja e rinisë në politikë nuk është vetëm një detyrim moral, por një domosdoshmëri për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme dhe të mbushur me shpresë për Kosovën. Pa këtë përkushtim, mungesa e rinisë në politikë do të mbetet një nga sfidat më të mëdha për demokracinë dhe të ardhmen e vendit.

## Walkeri dokumenton në libër masakrën e Reçakut, Kurti: Dëshmi e krimeve të luftës

**EPOKA ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 JANAR - Kryeministri Albin Kurti ka zhvilluar një takim me ambasadorin William Walker, ish-shef i Misionit Verifikues të OSBE-së, për të diskutuar një nga ngjarjet më të rëndësishme dhe tragjike të historisë moderne të Kosovës: Masakrën e Reçakut dhe dëshminë e paçmueshme të ambasadorit Walker për këto ngjarje. Në këtë takim, kryeministri Kurti shprehu mirënjohjen për angazhimin e ambasadorit Walker në mbështetje të së vërtetës dhe drejtësisë, si dhe për kontributin e tij në përkujdesjen dhe promovimin e ndihmës ndërkombëtare gjatë periudhës së luftës në Kosovë.

Kurti theksoi rolin domethënës dhe proaktiv të Qeverisë së Kosovës në përpjekjet për ta bërë të mundur botimin e librit të memoareve të ambasadorit Walker, i cili dokumenton ngjarjet e tmerrshme të masakrës së Reçakut.

Kryeministri Kurti shtoi se ky libër dhe këto dëshmi të ambasadorit Walker do të shërbejnë si një mjet për promovimin e së vërtetës për Kosovën dhe për forcimin e narrativës ndërkombëtare që vendi ynë ka përjetuar gjenocid nga ana e shtetit të Serbisë.

Vepra si ky libër na ndihmojnë ta ruajmë kujtimin e ngjarjeve të tmerrshme si masakra e Reçakut.



Në vijim u vlerësua angazhimi i qeverisë për realizimin e këtij projekti gjersa më 11 janar 2023, qeveria kishte miratuar vendimin për financimin e hulumtimit, shkrimit, editimit, përkthimit, shtypit dhe promovimit të librit të ambasadorit Walker, me një mbështetje financiare prej 70 000 eurove për këtë iniciativë të rëndësishme.

Ky financim do të sigurojë që ky libër të arrijë deri tek audiencia më të gjera dhe të kontribuojë në edukimin e brezave të rinj për historinë e Kosovës dhe luftën e saj për liri.

Ky libër pasqyron perspektivën e ambasadorit Walker si shef i Misionit Verifikues të OSBE-së dhe është një pasqyrë e vërtetë dhe e pazëvendësueshme e ngjarjeve që ndodhën më 15 janar 1999 në fshatin Reçak.

Ai është një akt i rëndësishëm që kontribuon në dokumentimin dhe shpërndarjen e dëshmimeve autentike për krimet e kryera nga regjimi i Serbisë në Kosovë, duke çuar përpara njohjen ndërkombëtare të gjenocidit që ka ndodhur në vendin tonë gjatë periudhës së luftës.

Libri kujton viktimat e masakrës së Reçakut dhe nderon të gjithë ata që dhanë jetën për lirinë e Kosovës. Pavarësisht prej 26 vjetëve të kaluara, Qeveria e Kosovës dhe populli ynë mbeten të angazhuar për të siguruar që e vërteta të mos harrohet kurrë dhe që përgjegjësit për gjenocidin të përballen me drejtësinë.



## Çfarë nuk u konvenon mërgimtarëve në zgjedhjet e 9 shkurtit

PRISHTINË, 14 JANAR - Profesori universitar Milazim Krasniqi ka shkruar në "Facebook" se mërgimtarët tanë e kanë ndihmuar shumë Kosovën në vitet e okupimit, ndërkaq në vitet e lirisë janë lidhur me Kosovën edhe më shumë. "Mijëra prej tyre kanë blerë këtu banesa, kanë ndërtuar shtëpi, vijnë masivisht në pushime. Interesimi i tyre për zgjedhjet në Kosovë është i natyrshëm. Çka nuk u konvenon atyre në këto zgjedhje? Nuk u konvenon

qeveri që është në konflikt me BE-në, sepse konflikti mund t'ua dëmtojë edhe pozitën atje. Nuk u konvenon qeveri që shkakton konflikte në shoqëri, me arsimtarët, me sindikatat, me opozitën, me komunitetet. Çka u konvenon atyre? Atyre u konvenon një Kosovë që zhvillohet, që afrohet më Bashkimin Evropian, sepse ashtu edhe pronave të tyre këtu u rritet vlera. U konvenon një Kosovë që

zgjdhë problemet edhe me Serbinë, ashtu që ata të udhëtojnë pa frikë e pa rrezik. Pra edhe mërgimtarëve u konvenon një Kosovë që arrin standarde evropiane, e jo një Kosovë që prodhon konflikte, siç po prodhon qeveria e tashme e Kurtit. Por nuk e di a ua ka shpjeguar mirë ndokush këtë realitet, meqë ata duke qenë larg Kosovës, shumë gjera nuk arrijnë t'i kuptojnë drejt", ka thënë Krasniqi.



## EULEX-i përforcon njësitin policor të specializuar në Kosovë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 JANAR - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) ka thënë të martën se është duke përfunduar Njësinë Policore të Specializuar Rezervë (NJPSR) nëpërmjet dislokimit të përkohshëm të pjesëtarëve të Forcës Evropiane të Xhandarmërisë (EUROGENDFOR) nga Franca, Italia, Lituania dhe Portugalia. Sipas njoftimit, këta policë do të punojnë "krah për krah me NJPS-në e siguruar nga Policia e Polonisë, për ta përbushur mandatin e misionit në mbështetje të stabilitetit në mbarë Kosovën dhe për të garantuar siguri për të gjitha komunitetet".

NJPSR-ja do të përbëhet nga asetet EUROGENDFOR-it të siguruar nga Xhandarmëria Kombëtare Franceze, Karabinierët Italianë, Shërbimi i Sigurisë Publike i Lituaniës dhe Garda Kombëtare Republikane e Portugalisë. NJPSR-ja pritet të arrijë në Kosovë gjatë ditëve në vijim për ta adresuar nevojën e Misionit për forca shtesë në terren për t'i mbështetur më mirë homologët kosovarë - duke përfshirë funksionimin si reagues i dytë i sigurisë në Kosovë, nëse kjo kërkohet dhe është e nevojshme. NJPSR-ja do të kryejë patrullime të dukshme dhe do të kontribuojë që Misioni të ketë pasqyrë të qartë për situatën. Ky do të jetë dislokimi i pestë i NJPSR-së së EULEX-it, ndërsa



dislokimi i parë është bërë në mars 2022.

EULEX-i shërben si reagues i dytë i sigurisë në Kosovë në kuadër të mekanizmit me tre nivele të reaguesve të sigurisë, ku Policia e Kosovës është reaguesi i parë i sigurisë,

EULEX-i është i dyti, kurse misioni KFOR i udhëhequr nga NATO është i treti.

Ky njoftim u bë një ditë pasi sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, tha se aleanca ushtarake perëndimore është në kontakt me zyrtarët në

Prishtinë dhe ata në Beograd që të sigurohet që të mos ketë destabilizim në Kosovë gjatë zgjedhjeve parlamentare që mbahen më 9 shkurt.

Rutte e ka quajtur situatën në Bosnjë-Hercegovinë dhe raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë si "çështje kyçe në rajonin e Ballkanit Perëndimor".

Gjatë këmbimit të zjarrit që pasoi në Banjskë të Zveçanit, u vranë edhe tre sulmues serbë.

Ndërkaq, në nëntor të vitit të kaluar ndodhi një shpërthim në kanal in e Ibër-Lepencit në Zubin Potok. Ky kanal furnizon me ujë disa komuna të Kosovës dhe uji i tij përdoret për ftohjen e termocentraleve.

Për të dy ngjarjet, Kosova e fajësoi Serbinë, e cila mohoi përfshirjen në sulme.

## Maqedonci dhe komandanti i FSK-së u pritën në Departamentin e Mbrojtjes së ShBA-së



PRISHTINË, 14 JANAR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, së bashku me komandantin e FSK-së, gjeneraljtënant Bashkim Jashari, dhe delegacionin përcjellës, u pritën nga ndihmës-sekretari i Mbrojtjes për NATO dhe Evropë, Alton Buland, në Departamentin e Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara. Fillimisht ministri Maqedonci foli për sukseset e përbashkëta në aktivitetet dypalëshe, planin e tranzicionit dhe me fokus të veçantë u fol për

realizimin e marrëveshjes kornizë ndërmjet vendeve tona në fushën e mbrojtjes.

Kjo marrëveshje do të hapë mundësi të reja në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Më pastaj gjeneral Jashari diskutoi për aktivitetet e shumta bilaterale ushtarake në mes të dy forcave si dhe për planet konkrete për bashkëpunim me Gardën Kombëtare të Ajovës.

Një diskutim tjetër i rëndësishëm ishin hapat e mëtutjeshëm për finalizimin e

planit 10-vjeçar të tranzicionit. Në anën tjetër Buland theksoi rëndësinë e partneritetit mes dy vendeve dhe ofroi mbështetjen e Departamentit të Mbrojtjes për rrugëtimin përpara drejt përbushjes së objektivave strategjike.

Të dyja palët u pajtuan që bashkëpunimi bilateral është në nivel të lartë dhe me hapa konkretë për zhvillim të mëtutjeshëm në shërbim të garantimit të interesave të sigurisë të dy vendeve tona.

## Haradinaj kërkon ndihmën e Britanisë për anëtarësim në NATO

PRISHTINË, 14 JANAR - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargraeves, me të cilin ka diskutuar me theks të veçantë për mbështetjen britanike për rrugën e anëtarësimit të Kosovës në



NATO. "Me ambasadorin ndamë vizionin e përbashkët për një Kosovë të integruar plotësisht në strukturat euroatlantike. Rruga jonë drejt NATO-s është e pakthyeshme dhe strategjiksht e domosdoshme për sigurinë rajonale. Mbretëria e Bashkuar vazhdon të jetë një

nga aleatët tanë më të fuqishëm në fushën e shtetndërtimit. Partneriteti ynë bilateral do të forcohet edhe më tej në funksion të objektivave tona të përbashkëta për një Kosovë e rajon të sigurt", ka thënë Haradinaj pas takimit.



## Fondi i Kursimeve Pensionale: 247.2 milionë euro kthimi bruto për 2024

PRISHTINË, 14 JANAR - Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës njofton se e ka përmbyllur vitin 2024 me 243.7 milionë euro kthimi bruto nga investimet. FKP-ja ka njoftuar se duke ia shtuar edhe suficitin e kthyer dhe të ardhurat e tjera (prej 3.5 milionë eurosh), kthimi bruto për 2024-n shkon në 247.2 milionë euro. "Në vlerë nominale, kjo është shifër rekord e kthimit nga investimet, porse erdhi edhe për shkak të mjeteve më të larta nën

menaxhim. Ky ishte viti i 20, nga gjithsej 23 vjet të operimit, që institucioni arrin kthim vjetor pozitiv nga investimet. Llogaritur në tërësi, kthimi i akumuluar bruto, prej themelimit e deri në fund të vitit 2024, arriti në 997.2 milionë euro, shumë afër shifrës simbolike prej 1 miliard eurosh", thuhet në njoftim.

Fondi i Kursimeve bën me dije se arkëtimi i kontributeve të reja në 2024-shin, në vlerë 315.8 milionë euro, pasqyron një

ngritje solide, si në vlerë nominale (prej +29.6 milionë eurosh) ashtu edhe në përqindje, prej 10.3 %, nga viti paraprak. "Kontributet e reja, bashkë me kthimin në investime, ndryshe nga tërheqjet e kursimeve dhe tarifave menaxhuese, kanë kontribuar pozitivisht që mjetet neto nën menaxhim të ngritën sivjet me shifrën rekorde prej +480.0 milionë eurosh e të arrijnë kështu afër 3.2 miliardë eurove".

Në komunikatën për medie bëhet me dije se prej 31 marsit 2024, FKP-ja ka tre portofola investues: Portofolin standard - për kontribuuesit deri në moshën 57-vjeçare; Portofolin e ndërmjetëm - për kontribuuesit e moshës 58 deri 62-vjeçare dhe Portofolin konservativ - për kontribuuesit e moshës 63-vjeçare e sipër.

Këta portofola kanë në përbërje instrumente të ndryshme financiare, varësisht synimit të kthimit nga investimet, riskut



dhe luhatshmërisë investuese dhe gjithnjë kundrejt distancës së kontribuuesve nga mosha e pensionimit.

## Rriten çmimet e konsumit në Kosovë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 JANAR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka njoftuar se çmimet e konsumit u rritën 1,1 % vjetore dhe 0,7 % mujore. "Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1,1 % në muajin dhjetor 2024 krahasuar me muajin dhjetor 2023. Inflacioni mujor ishte 0,7 % në muajin dhjetor 2024, ndërsa norma mesatare vjetore e inflacionit për vitin 2024 është 1,6 %", ka njoftuar ASK-ja.

### Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit për vitin 2024, 1,6 %



Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit në vend në vitin 2024 ishte më i lartë në një mesatare prej (1,6 %) krahasuar me vitin 2023. Ngritja e indeksit të çmimeve të konsumit është vërejtur te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: biletat e fluturimeve (10,8 %), kafja, çaji dhe kakao (8 %), pijet alkoolike (6,9 %), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (6,5 %), shërbimet financiare (5,8 %), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (5,3 %), qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (5,2 %),

sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat (5,1 %), pemët (4,8 %), gazetatat, librat dhe materialet për zyra (4,6 %), veshje (4 %), kujdesi personal (3,7 %), energjia elektrike (3,4 %), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (3,3 %), duhani (2,7 %), buka dhe drithërat (2,5 %), shërbimet hoteliere (2 %) dhe mishi (1,9 %) me një ndikim të përbashkët prej 2 përqindësh në IHÇK.

Ndërsa rënie e indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit gjatë vitit 2024 është vërejtur te nëngrupet e COICOP-it: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-4,4%)

dhe blerja e automjeteve (-1,8 %) me një ndikim të përbashkët prej -0,4-përqindësh në IHÇK.

### Dhjetor 2024/dhjetor 2023, 1,1 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1,1 % në muajin dhjetor 2024 krahasuar me muajin dhjetor 2023. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: kafja, çaji dhe kakao (14,4 %), vajrat

dhe yndyrat (9,3 %), shërbimet financiare (9,1 %), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (5,9 %), gazetatat, librat dhe materialet për zyra (5 %), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (4,8 %), qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (4,5 %), qumështi, djathi dhe vezët (3,8 %), pijet alkoolike (3,5 %), veshje (3 %), mishi (2,9 %), kujdesi personal (2,7 %), buka dhe drithërat (2,6 %), sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat (2,5 %), prodhimet ushqimore (1,8 %), shërbimet hoteliere (1,8 %), veglat dhe pajisjet për shtëpi dhe kopsht

(1,6 %), duhani (1,4 %), pajisje shtëpiake (1,2 %) dhe perimet (1 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2-përqindësh në IHÇK.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (-8,3 %), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-5,7 %), pemët (-4,1 %) dhe energjia elektrike (-2,2 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,9-përqindësh në IHÇK.

### Dhjetor 2024/nëntor 2024, 0,7 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0,7 % në muajin dhjetor 2024 krahasuar me muajin nëntor 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: biletat e fluturimeve (25,4 %), energjia elektrike (6,2 %), perimet (2,5 %), kafja, çaji dhe kakao (2,2%) dhe qumështi, djathi dhe vezët (1,3 %) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,8-përqindësh në IHÇK. Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: pemët (-2,5 %) dhe pijet alkoolike (-1,2 %) me një ndikim prej -0,1-përqindësh në IHÇK.

## Spanja planifikon taksën qind për qind për shtëpitë e blera nga banorët që nuk janë shtetas të vendeve anëtare të BE-së

MADRID, 14 JANAR - Spanja po planifikon të vendosë një taksë deri në qind për qind për pronat e blera nga jorezidentët nga vendet jashtë BE-së, si Britania e Madhe. Duke njoftuar masën, kryeministri Pedro Sanchez tha se masa "e paprecedentë" ishte e nevojshme për ta përmbushur urgjencën e strehimit. "Përfundimi

përballet me një sfidë vendimtare: Të mos bëhet një shoqëri e ndarë në dy klasa, pronarët e pasur dhe qiramarrësit e varfër", tha ai. Banorët jashtë vendeve të BE-së blenë 27 000 prona në Spanjë më 2023, tha ai në një forum ekonomik në Madrid, "jo për të jetuar", por "për të fituar para prej tyre". "Në kontekstin e mungesës në të

cilën ndodhemi, padyshim nuk mund ta lejojmë", shtoi ai. Prandaj, lëvizja ishte krijuar për të "përparuar që shtëpitë e disponueshme të jenë për banorët", theksoi Sanchez. Ai nuk dha hollësi se si do të funksiononte taksata dhe as një afat kohor për paraqitjen e tij në parlament për miratim, ku ai shpesh ka luftuar për të mbledhur vota

të mjaftueshme për ta miratuar legjislacionin. Por qeveria e tij tha se propozimi do të finalizohet "pas një studimi të kujdesshëm". Është një nga dhjetëra masat e planifikuara të shpallura nga kryeministri të hënën që synojnë përmirësimin e përbalueshmërisë së banesave në vend.





# Pse liberalët stërmundohen për t'u përballur me ndryshimin epokal

*Gabimi i mitologjisë së tyre për vitin 1989 ka rëndësi, sepse sot përballemi me një tjetër moment të tillë që ndan dy epoka*



**Nga Ivan KRASTEV**

Teksa vëzhgoja dëshpërimin e liberalëve në të gjithë botën pas fitores së Donald Trump-it në zgjedhjet presidenciale të nëntorit në SHBA, pata një ndjesi të ngjashme me diçka që kam përjetuar më parë. Ky moment më ktheu pas në vitin 1989, kur ra Muri i Berlinit, duke shënuar fillimin e fundit të komunizmit sovjetik dhe heqjen e Perdes së Hekurt, e cila kishte ndarë Evropën që nga Lufta e Dytë Botërore. Dallimi ishte se bota që u shemb në vitin 1989 ishte e tyre, pra e komunistëve. Tani është e jona, e liberalëve.

Në vitin 1989, jetoja në një shtet të Paktit të Varshavës, dhe kur bota u përmbys isha në vitin e fundit të studimeve të filozofisë në Universitetin e Sofjes në Bullgari. E gjithë ajo eksperiencë ndihej si një kurs i zgjatur universitar në ekzistencializmin francez. Të shihje fundin e papritur të diçkaje që na kishin thënë se do të zgjaste përgjithmonë ishte një ndjenjë tronditëse – çliruese dhe shqetësuese njëkohësisht. Ne, studentët, ishim të pushtuar nga ndjenja e re e lirisë, por ishim gjithashtu të vetëdijshëm për brishtësinë e çdo gjëje që kish lidhje me politikën. Ajo ndarje radikale mes dy kohëve rezultoi të ishte një përvojë përcaktuese për brezin tim.

Por ajo këputje ishte edhe më e gjerë – në një shkallë globale më të madhe – se sa e kuptonim në atë kohë. Viti 1989 ishte me të vërtetë një annus mirabilis, por shumë ndryshe nga mënyra se si liberalët perëndimorë e kanë përshkruar në tre dekadat e fundit. Vendosmëria që Partia Komuniste e Kinës tregoi në shtypjen e lëvizjes prodemokracisë në Sheshin Tiananmenit rezultoi të kishte ndikim më të fortë, sesa rrëzimi i Murit të Berlinit.

Për rusët, aspekti më i rëndësishëm i vitit 1989 nuk ishte fundi i komunizmit, por fundi i perandorisë sovjetike, me tërheqjen e trupave të saj nga Afganistani. Ishte pra, viti kur Osama bin Laden shpalli fitoren e xhihadistëve ndaj BRSS-së ateiste. Dhe 1989 ishte gjithashtu viti kur nacionalizmi filloi të rimerre epërsi politike

në ish-Jugosllavi. Rikthimi i Donald Trump-it në pushtet në SHBA mund të jetë një tjetër rast që shënon një ndarje të tillë politike me përmasa të mëdha. Nëse liberalët duan t'i përgjigjen sfidës së një administrate të re të Trump-it, ata duhet të reflektojnë me kujdes për atë që ndodhi në vitin 1989 dhe të hedhin poshtë narrativën që i kanë thënë vetes deri sot. Mënyra më e mirë për të kapërcyer dëshpërimin është të kuptosh më mirë atë që ka ndodhur.

Nga një këndvështrim liberal, krahasimi i revolucioneve anti-sovjetike të vitit 1989 me revolucionet illiberale të ditëve të sotme mund të duket skandaloz. Në frazën e famshme të Francis Fukuyama-s, 1989 ishte "fundi i historisë," ndërsa fitorja e Trump-it, sipas shumë liberalëve, mund të paralajmërojë fundin e demokracisë.

Viti kur ra Muri i Berlinit shihej si triumfi i Perëndimit; tani dominon diskursi për rënien e Perëndimit.

Shembja e komunizmit shënohej nga një vizion për një të ardhme demokratike dhe kapitaliste; ajo e ardhme tani është plot pasiguri.

Në vitin 1989, atmosfera ishte ndërkombëtare dhe optimiste; sot ajo është kthyer në nacionalizëm dhe herë pas here, edhe nihilizëm.

Por këmbëngulja mbi këto ndryshime midis asaj kohe dhe tani bën që të humbasësh thelbin e ngjashmërive të tyre. Të jetosh në momente të tilla të historisë të mëson shumë gjëra, por më e rëndësishmja ndër to, është shpejtësia e ndryshimit: njerëzit mund të ndryshojnë totalisht pikëpamjet dhe identitetin e tyre politik brenda natës; ajo që vetëm dje konsiderohej e pamendueshme, duket sot e vetëkuptueshme. Ndryshimi është aq i thellë sa që njerëzit i shohin shpejt si krejt të pakonceptueshme, ato që ishin dikur supozimet dhe zgjedhjet e tyre.

Trump-i rroku imagjinatën e publikut jo sepse kishte një plan më të mirë për të fituar luftën në Ukrainë, apo për të menaxhuar globalizimin, por sepse kuptoi që bota e djeshme nuk mund të ekzistonte më. Identiteti politik i pasluftës i Shteteve të Bashkuara, ka humbur në gremenin e kutsisë së votimit. Kjo administratë e Trump-it mund të ketë sukses ose mund të dështojë sipas rrethanave, por bota e vjetër nuk do të kthehet më. Madje shumica e

liberalëve as nuk e duan më. Pak amerikanë ndihen sot mirë me idenë e "veçantisë amerikane."

Pas fitores së Trump-it, disa komentatorë politikë i kthyen sytë drejt viteve 1930, kur fashizmi kërcënonte botën. Problemi është se vitet 1930 janë përtej kujtesës së gjallë, ndërsa vitet 1990 janë ende të freskëta për shumë prej nesh. Ajo që kam mësuar nga ajo dekadë është se një këputje politike radikale, u jep fituesve një "çek të bardhë". Të kuptuarit e arsyes pse njerëzit votuan për Trump-in nuk ndihmon shumë, për të kuptuar atë që ai do të bëjë në zyrë.

Thyerje të tilla politike arrihen nga koalicionet të paimagjinueshme më parë, të bashkuara më shumë nga intensiteti, sesa një program i përbashkët. Politikanët që i përkasin këtyre koalicioneve zakonisht kanë një aftësi të ngjashme me kameleonin për t'iu përshtatur momentit – jo më shumë, në kohën tonë, sesa Trumpi.

Liberalët amerikanë, të cilët janë hutuar, se si ka mundësi që njerëzit mund ta trajtojnë një playboy miliarder si udhëheqës të një lëvizjeje anti-establishment, mund të kujtojnë se Boris Jelsini, heroi i revolucionit antikomunist të viteve 1990 në Rusi, vetëm pak vite më herët kishte qenë një nga udhëheqësit e Partisë Komuniste.

Ashtu si fundi i epokës sovjetike, rizgjedhja e Trumpit do të ketë dimensione globale. Ajo shënon fundin e Shteteve të Bashkuara si një perandori liberale. Amerika mbetet fuqia kryesore e botës, po, dhe do të mbetet një lloj perandorie, por nuk do të jetë një perandori liberale. Siç ka dëshmuar historia e njollosur e Biden-it për mobilizimin e mbështetjes për mbrojtjen e "rendit ndërkombëtar liberal" përballë pushtimit rus të Ukrainës, vetë ideja e një rendi të tillë, sipas shumë kritikëve kish qenë gjithmonë një trillim perëndimor. Ajo ekzistonte për sa kohë që SHBA-të kishin fuqinë dhe vullnetin politik për ta imponuar.

Trumpi nuk do ta bëjë këtë. Në politikën e jashtme, Trumpi nuk është as realist, as izolacionist; ai është revizionist. Trumpi është i bindur se SHBA është humbësja më e madhe, në botën që ka krijuar po vetë. Sipas pikëpamjes së tij, në tre dekadat e fundit Amerika është bërë një peng, dhe jo një hegjemon i rendit ndërkombëtar liberal. Në

botën e pasluftës, SHBA integroi me sukses kundërshtarët e vet të mundur, Gjermaninë dhe Japoninë, në qeverisjen demokratike, tregtinë ndërkombëtare dhe begatinë ekonomike. Kjo nuk u zbatua për Kinën: sipas këndvështrimit të Trumpit, Pekini ka qenë fituesi i vërtetë i ndryshimeve të pas 1989-ës. Ardha e dytë e Trumpit do të jetë padyshim e ndryshme nga e para. Në 2016, takimi i Trumpit me pushtetin amerikan ishte si një nga ato takimet e një çifti, që nuk janë njohur kurrë më parë. Ai nuk dinte me saktësi se çfarë donte, dhe pushteti amerikan nuk dinte me saktësi se kush ishte Trumpi. Jo më.

Amerika mund të mbetet demokraci, por do të bëhet më e egër. Nën udhëheqjen e re, institucionet e saj me siguri do t'i largohen sigurisë së politikës konsensuale dhe do të marrin kot. Në kohë ndryshimesh të shpejta, udhëheqësit politikë nuk përpriqen ta administrojnë shtetin, por ta mundin atë. Ata i shohin shtetin dhe "shtetin e thellë", si sinonime. Udhëheqësit joliberalë i zgjedhin anëtarët e kabinetit ashtu sikurse perandorët zgjidhnin dikur guvernatorët e provincave rebele: Ajo që ka më shumë rëndësi është besnikëria e të emëruarit, dhe aftësia e tij për t'i rezistuar kooptimit apo korrupsionit prej të tjerëve.

Në administratën e parë të Trumpit, mbretëroi kaosi; administrata e tij e dytë do të mbretërojë duke përdorur kaosin si armë. Kjo Shtëpi e Bardhë do të mposhtë kundërshtarët duke "përmbytur terrenin" me urdhra ekzekutivë dhe deklarata. Ai do të lërë shumë kundërshtarë të hamendësojnë se përse po merr vendimet që merr dhe do t'i çorientojë të tjerët me shpejtësinë dhe sasinë e tyre. Në vitin 2020, Bideni mundi Trumpin duke premtuar normalitet. Normaliteti nuk do t'i ndihmojë më demokratët. Në shembullin më të fundit të një fitoreje antipopuliste, Donald Tusk triumfoi në zgjedhjet parlamentare të Polonisë në vitin 2023 dhe u kthye si kryeministër, jo sepse premtoi normalitet, por sepse partia e tij, Platforma Qytetare, ishte në gjendje të krijonte një identitet të ri bindës politik. Partia e Tusk miratoi qëndrime më progresive për çështje të tilla të diskutueshme si të drejtat e abortit dhe mbrojtja e punëtorëve, por gjithashtu u mbështoll me flamur dhe

përqafoi patriotizmin. Tusk u ofroi polakëve një narrativë të re dhe pompoze, jo thjesht një strategji të ndryshme zgjedhore. Suksesi i Platformës Qytetare varej ende nga formimi i një koalicioni me partitë e tjera, një bazë potencialisht e brishtë për qeverisje, por ajo ofron, të paktën, një model se si qendra liberale mund të ribëhet dhe të frenojë përparimin e populizmit joliberal.


Rreziku për Shtetet e Bashkuara është i lartë: vitet e ardhshme, politika amerikane mund të bjerë kollaj në një hakmarrje mizore çikërrimash, ose më keq. Por nuk do të ishte e mençur që liberalët t'i përgjigjen këtij momenti duke vepruar si mbrojtës të një status quo-je që po zhduket. Kjo do të nënkuptonte thjesht reagimin ndaj çdo gjëje që bën Trumpi. Mendësia e rezistencës mund të jetë mënyra më e mirë për të kuptuar tiraninë, por nuk është mënyra më e mirë për të trajtuar një moment këputjeje radikale politike, në të cilin tirania është e mundur, por jo e pashmangshme.

Në 1989, politologu Ken Jowitt, autor i një studimi shumë të mirë të kryengritjeve komuniste në atë periudhë, "Kaosi i Ri Botëror", vërente se një këputje e tillë i detyron udhëheqësit politikë të hartojnë një fjalor të ri politik. Në momente të tilla, fjalë që më parë kanë qenë magjike nuk funksionojnë më. Slogani "Demokracia në rrezik" nuk u solli dobi demokratëve gjatë zgjedhjeve, sepse shumë votues nuk e shihnin vetë Trumpin si rrezik.

Siç vërente shkrimtari George Orwell, "është një përpjekje konstante që të shikosh atë që ke mu përpara hundës". Sfida e të kuptuarit të të resë, edhe atëherë kur fakti i mbërritjes së saj është i pamohueshëm, do të thotë se ndjeshmëritë e liberalëve do të pësojnë tronditje kur të shohin se sa pak lotë do të derdhen për fundin e rendit të vjetër. Ndryshe nga sa dukej korrekte në vitin 2016, detyra e kundërshtarëve të Trumpit sot nuk është që t'i rezistojnë ndryshimit politik që ai ka sjellë, por ta përqafojnë atë – dhe ta përdorin këtë moment për modelimin e një koalicioni të ri, për një shoqëri të re. / The Atlantic – Bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Inverit  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## KB Trepça ‘blindon’ Dardan Kapitin

**MITROVICË, 14 JANAR** - KB Trepça ka njoftuar se e ka vazhduar kontratën edhe për dy vjet të tjera me njërin prej basketbollistëve më të mirë në Kosovë, Dardan Kapiti. “Dardan Kapiti do të jetë pjesë e Trepçës edhe për dy sezonet e ardhshme. Ai do të

vazhdojë me ngjyrat gjelbër e zi drejt sukseseve të reja. Së bashku do të bëjmë çdo sfidë mundësi!”, thuhet në njoftimin e Trepçës. 24-vjeçari ka qenë pjesë e sukseseve historike sezonin e kaluar me “xehetarët”, ku kanë fituar katër trofe dhe

kanë rikthyer titullin kampion në Mitrovicë pas 12 vitesh. Teksa këtë sezon me paraqitjet e tij të mira ka bërë që të jetë vendimtar edhe në triumfin e Superkupës, Kapiti këtë sezon po luan me mesatare prej 9.9 pikëve dhe 7.8 kërcimeve për lojë.



# Përkushtim dhe optimizëm nga futbollistët në ditën e tretë të kampit stërvitor

**PRISHTINË, 14 JANAR** - Dita e tretë e kampit stërvitor me futbollistët kandidatë potencialë për Përfaqësuesen A u karakterizua nga puna intensive dhe angazhimi maksimal i futbollistëve. Përzgjedhësi Franco Foda, së bashku me stafin, vazhdoi t’ua përcjellë lojtarëve strategjinë dhe filozofinë e lojës, duke vendosur bazat për zhvillimin e tyre të mëtejshëm. Stërvitjet gjatë këtyre ditëve janë fokusuar jo vetëm në aspektin fizik dhe teknik, por edhe në aspektet taktike, duke ndihmuar futbollistët të përshtaten me standardet dhe kërkesat e Përfaqësuesen A. Pas përfundimit të stërvitjes, disa nga lojtarët e përfshirë në këtë kamp shprehën emocionet dhe përshtypjet e tyre rreth punës dhe atmosferës në këtë



grumbullim. Julind Selmonaj, anëtar i FC Basel U21, u shpreh krenar që

është pjesë e këtij kampi dhe vuri në pah se përvoja e fituar këtu do t’i ndihmojë atij në të

ardhmen. Elvir Gashijani, pjesë e KF Llapi, e vlerësoi këtë kamp si një mundësi të shkëlqyer për

t’i treguar aftësitë e tyre para përzgjedhësit Foda dhe shprehu optimizëm se pas paraqitjeve në ekipet kombëtare zinxhir, do t’i vijë mundësia që vlerat e tij t’i tregojë edhe në Kombëtaren A. Arianit Fazlija, anëtar i skuadrës gjermane Greuther Fürth II, theksoi se me filozofinë e lojës së trajnerit Foda është adaptuar shumë mirë dhe shprehu shpresën se me punë të vazhdueshme në të ardhmen mund të jetë pjesë e grumbullimeve zyrtare. Ndërkaq Aulon Bitiqi nga skuadra suedeze Varbergs BoIS tha se ky zemra e tij rrah për Kosovën dhe e vlerësoi këtë kamp si mundësi të mirë për secilin prej lojtarëve për t’i treguar cilësitë e tyre. Kampi do të përfundojë sot (e mërkurë) me stërvitjen e fundit, e cila do të zhvillohet në mesditë.

## Sonte zhvillohen gjysmëfinalet e para të Kupës në basketboll

Gjysmëfinalet e Kupës së Kosovës do të dhurojnë spektakël të basketbollit, ku katër skuadra duan kualifikimin në finalen e madhe. Gjysmëfinalet do të zhvillohen me sistemin vajtje-ardhje dhe kush është më e mirë në dy takimet, kualifikohet në finale. Gjysmëfinalja e parë do të zhvillohet mes skuadrave rivale, Sigal Prishtinës dhe Trepçës, ku pritet një super sfidë në Palestrën “1 Tetori”. Dy skuadrat kanë traditë në basketbollin e



Kosovës dhe do të luftojnë për fitoren në ndeshjen e parë, që është shumë e rëndësishme. Prishtinasit në çerekfinale eliminuan Pejën, derisa mitrovicasit skuadrën e Proton Cable Prizrenit. Në ProCredit Superligë të dyja skuadrat kanë nga një fitore ndaj njëra-tjetrës. Gjysmëfinalja tjetër, po ashtu, pritet të jetë mjaft interesante në mes të Vëllaznimit dhe Bashkimit në Gjakovë. Këto dy skuadra u përballën të dielën në Prizren, ndeshje që përfundoi

me fitoren e vendasve 84:73, ndërsa në dy takimet e tjera në elitë, dy skuadrat kishin nga një fitore ndaj njëra-tjetrës. Kuqezinjtë në çerekfinale eliminuan Golden Eagle Yllin, ndërsa prizrenasit eliminuan Borën.

### KUPA E KOSOVËS (GJYSMËFINALET)

**Të mërkurën takohen:**  
19:00 Sigal Prishtina - Trepça  
19:00 Vëllaznimi - Bashkimi

## Hysaj nuk largohet nga Lazio

**ROMË, 14 JANAR** - Pavarësisht prej lajmeve të shumta se Elseid Hysaj do të largohet nga Lazio, mbrojtësi i krahut do të mbetet pjesë e ekipit italian deri në fund të sezonit aktual. Kjo bëhet me dije se trajneri i

Lazios, Marco Baroni, që dëshiron ta mbajë Hysajn në ekip për shkak të lëndimit të Manuel Lazzarit, i cili nuk do të kthehet deri në fund të muajit të ardhshëm. Mbrojtësi pritet të ketë minuta më të

madhe këtë sezon dhe atë duke filluar nga ndeshja e ardhshme që Lazio e luan kundër Veronës në fundjavë. 30-vjeçari ka kontratë me klubin romak deri në verën e vitit të ardhshëm, ndërsa këtë

sezon ka vetëm katër paraqitje në të gjitha garat. Hysaj ishte në listën e lojtarëve që Lazio planifikonte t’i largonte këtë muaj dhe Empoli e Lecce ishin skuadrat e interesuara për shërbimet e tij.





## Verstappen: Daniel Ricciardo është shoku im më i mirë i skuadrës

**HASSELT, 14 JANAR** - Në moshën 27-vjeçare Max Verstappen nuk është më një pilot i ri në Formula 1, ndërkohë që ka fituar edhe katër tituj kampionë bote. Holandezi, pasi bëri debutimin e tij si “i mitur”, tashmë ka 10 vjet që garon me më të mirët në botë,

karrierë e cila pritet të vijojë gjatë. Në këto vite të karrierës së tij në Formula 1, Verstappen ka pasur dhe mposhtur mjaft nga shokët e tij të skuadrës. Disa prej tyre i ka “shkatërruar” në pistë, si Albon, Gasly dhe Perez. Ndërsa me Carlos Sainz (në kohën e Toro Rosso) dhe

Daniel Ricciardo (shoku i tij i parë i skuadrës në Red Bull) e përballuan rivalitetin. Në një intervistë, Verstappeni pranon se Daniel Ricciardo ka qenë ishte një shkollë e vërtetë për të. “Daniel ishte padyshim shoku im më i fortë i skuadrës, kam mësuar shumë prej tij. Përvetësua

shumë dhe i përfshiva ato mësimet në bagazhin tim të karrierës”, ka thënë holandezi për “Blick”. Ndërsa për Perez, i cili u largua disa javë më parë nga Red Bulli, tha: “Ne ishim një ekip i mirë për katër vjet. Sergio ka qenë gjithmonë besnik dhe kjo është një cilësi që e vlerësoj



shumë. Lawson? Nuk e di se si do të shkojë, rëndësi ka që Red Bulli të rikthehet sërish kampion”.

## Për herë të tretë radhazi futbollisti i vitit në Zvicër, Xhaka: Jam i lumtur për çmimin

**CYRICH, 14 JANAR** - Granit Xhaka është zgjedhur futbollisti më i mirë i vitit në Zvicër për herë të tretë radhazi. Ylli nga Kosova e fitoi këtë çmim në ceremoninë e mbajtur mbrëmë në Bern. 32-vjeçari u ndie i lumtur për këtë mirënjohje dhe vlerësim për kontributin e dhënë në nivelin e klubeve dhe për Kombëtaren helveticë. “Jam mjaft i lumtur për çmimin. Ky nuk ishte viti im. Ishte viti ynë, me pjesëmarrjen në Kampionat Evropian. Dua t'i falënderoj të gjithë përsëri, posaçërisht trajnerin Murat Yakin, i cili më ka mbështetur, në ushtrime dhe në aspektin privat”, ka thënë Xhaka përmes një video-xhirimi pasi s'mund të ishte në këtë ceremoni. Viti 2024 ishte me të vërtetë i jashtëzakonshëm për Granit Xhakën. Ylli nga Kosova e kaloi një vit përrallor duke e fituar titullin e kampionit dhe atë historik në Bundesligë me Bayer Leverkusenin, ndërsa fitoi edhe



Kupën e Superkupën e Gjermanisë me “Farmaceutikët”. Ndër të tjera, me kuqezinjët shkoi deri në finale të Ligës së Evropës ku, fatkeqësisht, humbi në finale nga Atalanta. Gjithashtu, ish-futbollisti i Baselit, Borussia Monchengladbachut e Arsenalit bëri paraqitje fantastike edhe në Euro 2024 me Zvicrën. E krejt këto bënë që futbollisti me prejardhje

llapjane të futej në listën e gjerë të “Topit të Artë”, duke e shkruar historinë si futbollisti i parë shqiptar që e bën një arritje të tillë. Ditë më parë mesfushori kualitativ u zgjodh sportisti i vitit në Zvicër, kurse mbrëmë Xhaka e fitoi një tjetër çmim. 32-vjeçari u zgjodh futbollisti më i mirë i vitit në Zvicër për herë të tretë radhazi.

## Lakersat dhe Golden State në krizë; clippersat, ‘leksion’ Miamit

**LOS ANXHELOS, 14 JANAR** - Ekipi i lakersave rikthehet të luajë në shtëpi pas shtyrjes së dy ndeshjeve për shkak të zjarreve në Los Anxhelos. Kalifornianët u mundën me rezultat 126-102 në shtëpi nga San Antonio. Tri lojtarë të Spursit realizuan nga 23 pikë secili, duke i bërë të pavlefshme 30 pikët e Davisit për vendasit. Humbet edhe skuadra e Golden States, që u mund me rezultat 104-101 nga Toronto. Curry



realizoi 26 pikë për miqtë, por që s'mjaftuan, ndërsa për kanadezët u dallua Barnes me 23 pikë. Pa probleme fitoi Minnesota, 120-106 ndaj Washingtonit, sfidë ku Anthony Edwards e mbylli me 41 pikë. Fitoi skuadra tjetër e Los Anxhelosit, ajo e Clippersit, që

mundi me rezultat 109-98 Miami. Powelli me 29 pikë e Hardeni me 26 pikë bënë dallimin në fushë për vendësit. Fitore në sekondat e fundit për Houstonin, që mundi me rezultat 120-118 Memphisin, sfidë ku u dallua Jalen Greeni me 42 pikë.

### REZULTATET

Washington - Minnesota	106-120
New York - Detroit	119-124
Toronto - Golden State	104-101
Houston - Memphis	120-118
Clippers - Miami	109-98
Lakers - San Antonio	102-126

## Ronaldo, gati rinovimin me vlerë 200 milionë euro me Al Nassrin

Cristiano Ronaldo dhe Al Nassr sërish bashkë. Sipas asaj që është raportuar nga shtypi saudit, por edhe nga shtypi spanjoll, në fakt, sulmuesi portugez është

gati të nënshkruajë një rinovim të kontratës deri në qershor 2026 me vlerë 200 milionë euro. Një marrëveshje do të bëjë Ronaldon të luajë deri në

moshën 41-vjeçare. E ardhmja e Ronaldos do të vazhdojë të jetë në Ligën Saudite. Rinovimi i futbollistit (i cili do ta festojë ditëlindjen e tij të 40

në shkurt) do ta zgjasë për një vit praninë e tij në Arabinë Saudite, vend i cili po përgatitet edhe për organizimin e Botërorit 2034, ambasador i të cilit

është Ronaldo. Në Al-Nassr që nga viti 2023 Ronaldo ka luajtur në 84 ndeshje për klubin saudit, duke shënuar 75 dhe duke dhënë 18 asistime.

### SHKURT

#### Lazio paraqet Arijon Ibrahimoviçin

Sulmuesi Arijon Ibrahimoviç tashmë është pjesë e skuadrës së Lazios që bën gara në Serinë A të Italisë. Klubi italian të martën e ka zyrtarizuar Ibrahimoviçin, i cili i është bashkuar nga skuadra e Bayern Munchenit. Në fakt, Lazio e ka huazuar 19-vjeçarin deri në fund të këtij sezoni me opsionin e blerjes së tij për 8 milionë euro, ndërsa Bayerni ka ruajtur opsionin e riblerjes për Ibrahimoviçin. Ibrahimoviçi e njeh kampionatin italian, pasi sezonin e shkuar ishte i huazuar te Frosinone, ku shënoi 1 gol dhe bëri 1 asistim në 16 ndeshje kampionale. Këtë sezon Ibrahimoviçi ka regjistruar 3 paraqitje në të gjitha garat për Bayernin, ndërsa në ekipin e parë është promovuar në vitin 2023. Ai me Bayernin ka kontratë deri në verën e vitit 2027.

#### Tyson Fury i jep fund karrierës

Boksieri i njohur britanik Tyson Fury ka njoftuar të hënën për pensionimin e menjëhershëm nga boksi. Njoftimi i boksierit erdhi vetëm dy ditë pasi promotori Eddie Hearn, zbuloi se ka rezervuar stadiumin “Wembley” në Londër për meçin e shumëpritur të Furyt me Anthony Joshuan, në verë. Fury ishte pensionuar edhe në vitin 2022, por u kthye gjasthë muaj më vonë: “Dua të njoftoj për tërheqjen time nga boksi”, thotë Fury në një video të postuar në “Instagram”. Ai së fundmi humbi nga Oleksandr Usyk në luftë për tituj të botës. Si profesionist, Fury gjatë karrierës së tij ka zhvilluar 37 meçe, ku ka regjistruar 34 fitore, 2 humbje dhe 1 barazim.

#### Lëndimet e shumta, Arsenali kërkon Comanin

Anësori i Bayern Munchenit, Kingsley Coman, thuhet se ka përfunduar si objektiv kryesor i Arsenalit për fazën e sulmit. Sipas raportit të fundit të “Fichajes”, Arsenali pas lëndimeve të lojtarëve sulmues si Bukayo Saka, Gabriel Jesus dhe Ethan Nwanieri po interesohet për Comanin. Arsenali do të duhet të bëjë një ofertë të rëndësishme për 28-vjeçarin, pasi klubi gjerman nuk është i interesuar ta shesë lojtarin në mes të sezonit. Sulmuesi anësor francez ka shënuar 4 gola dhe ka dhënë 2 asistime në 20 ndeshje këtë sezon.

#### Kvaratskhelia transferohet për 75 milionë euro te PSG-ja

Napoli dhe PSG-ja kanë arritur marrëveshje për transferimin e sulmuesit Khvicha Kvaratskhelia. Në arkat e klubit italian do të shkojnë rreth 75 milionë euro, ndërsa mungojnë vetëm hollësitë e fundit për t'u zgjidhur. Ylli gjeorgjian ka dhënë miratimin prej kohës, për t'u transferuar në kryeqytetin francez. Napoli ndërkohë është në kërkim të një zëvendësuesi. Italianët kanë “piketuar” Alejandro Garnacho nga Manchester United, për të cilin anglezët kërkojnë 45 milionë euro. Alternativë është edhe Federico Chiesa, në huazim nga Liverpoolsi deri në fund të sezonit.





## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898  
Sallon Depilimi Lume's Details  
lumesdetails  
Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Shkumbim Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m.u. "Zekeria Rexha". Informata në tel. 044/171-328.
- Përparim Ahmetaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha".
- Fatlind Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Fazli Memcaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Pjeter Budi " Lubizhd e Hasit.
- Fatime Rexha shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Ilir Bytyqi shpall te pavlefshme diplomën Q.K "11 Marsi " Prizren.
- Mimoza Durakaj shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi " Prizren.
- Eljesa Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme të Gjimnazit "Hajdar Dushi".
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales







**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

